

## AKTI I THEMELIMIT

### I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ KASTE LA – 3D ” Sh.p.k.

#### NENI 1

Ne Sarande sot me daten 28.10.2023 shtetasi i poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

“ KASTE LA – 3D ” Sh.p.k.

#### NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: “ KASTE LA – 3D ” Sh.p.k. do te jete ne adresën: Sarande, Lagjja nr.1, Rruga Telat Noga, Godina nr.10, Kati 3, Ap.nr.14

#### NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “ KASTE LA – 3D ” Sh.p.k. do te jete:

Projektim, Ndertim te te gjitha llojeve. Ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tunele, mbikalime dhe nenkalime, ujesjellsa, ndertime mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale. Te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit dhe te trashegimise kulturore, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas Kodit Civil. Aktivitete Inxhinierike dhe konsulenca te lidhura me to si projekte inxhinierike, studime dhe vrojtime gjeologjike, aktivitete hartografike, aktivitete topografike, studime te ndikimit ne mjedis, pyjore etj. Kontrolle teknike, aktivitete kerkimi dhe zhvillimi si dhe kontrolle dhe analiza teknike te lidhura me to si dhe certifikime DDD. Sherbime Akomodimi, Mjete motorike me qera, Agjensi Imobiliare. Import – Export.

## NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqindmije) leke, formuar dhe nenshkuar nga 1 ortak ose 1 kuote .

- Ortaku themelues: KASTRIOT BELLO: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njqinde mije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët kanë pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

## NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

## NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqerise , të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqerise.

## NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në leke dhe në çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

## NENI 9

Organet drejtuese të shoqerise janë:

1-Asambleja e Ortakëve

2-Administratori

Kompetencat e Asamblese së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqerise tregtare “ KASTE LA – 3D ” Sh.p.k.

## NENI 10

Shoqëria do të drejtohet nga 1 Administrator për një afat 5 vjeçar:

Administratori do të jetë:

Z. KASTRIOT BELLO



#### **NENI 11**

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën kompetentë për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

#### **NENI 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (të ndryshuar).

#### **NENI 13**

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit u përpilua në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua rregullisht nga ortakët themelues.

**Themeluesi i shoqërisë**

**KASTRIOT BELLO**

